



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË



Nr: 1209 Prot

Tiranë, më 14.10.2014
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA NJOFTIM PËR VËNDE TË LIRA PUNE

Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Per sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të VKM Nr.66, datë 03.02.2010 "Per riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore", si dhe të Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", shpall konkursin për vendet e lira në pozicionin **Drejtore i Institucionit Arsimor Publik** në :

1. Shkollën e Mesme të Bashkuar Vaqarr, Tiranë.
2. Shkollën 9 vjecare Katund i Ri, Tiranë.
3. Gjimnazin Katund i Ri, Tiranë.
4. Shkollën e Mesme të Bashkuar Surrel, Tiranë.
5. Shkollën e Mesme të Bashkuar Krrabë, Tiranë.
6. Shkollën e Mesme të Bashkuar "Mersin Duqi" Ibë, Tiranë.

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

Kandidati/ja për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9741, date 21. 5. 2007 "Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë),
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" (fotokopje e noterizuar e dëshmisë së kualifikimit)
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij (nëse nuk ka, e deklaron me shkrim që nuk ka).

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

- a) Kërkesë me shkrim në lidhje me institucionin publik arsimor në të cilin, kandidati/ja kërkon të aplikoj,
- b) CV - në dhe kopjet që dëshmojnë pohimet në CV (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013),
- c) Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013),
- ç) Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit,

d) Dy rekomandime nga mësues, drejtorë të institucioneve arsimore, ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë viteve të fundit. (Sipas modelit të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013).

Dokumentacioni për aplikim paraqitet në zarf të mbyllur.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit do të bëhet pranë Sekretarisë së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, me adresë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, cdo ditë nga dita e hënë në të enjte nga ora 08:00 – 16:30 dhe ditën e premte nga ora 08.00 – 14.00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit do të jetë data 24 Tetor 2014 ora 14.00.

Drejtori aktual i institucionit arsimor publik përkatës, do të vërë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme, të nevojshme për zhvillimin e konkurimit :

- a) Plani afatmesëm i shkollës.
- b) Plani vjetor i shkollës i vitit pararendës,
- c) Raporti vjetor i shkollës i vitit pararendës.

Faza e parë e konkurimit do të zhvillohet me 27 Tetor 2014, në prani të komisionit të vlerësimit, pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë.

DREJTOR

Eglantina METANI

